

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për krime të rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Mejreme Memaj, kryetare, Driton Muharremi e Have Haliti, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Përparim Zeka procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit Xh.S. nga Skenderaji, për shkak të veprave penale Prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotrope nga neni 230 të KPK-së, Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotrope nga neni 229 par.2 të KPK-së dhe veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.2 të KPK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Mitrovicë, PKR.nr.5/2011 datë 27.10.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me 16.01.2018 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Mitrovicë, PKR.nr.5/2011 datë 27.10.2017, **vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Mitrovicë me aktgjykimin PKR.nr.5/2011 datë 19.10.2017, në bazë të nenit 364 par.1 pika 1.3 të KPP-së e ka liruar nga akuza të akuzuarin Xh.S., për shkak të veprave penale, Prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotrope nga neni 230 të KPK-së, Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotrope nga neni 229 par.2 të KPK-së, kurse në bazë të nenit 363 par.1 pika 1.1 të KPP-së merr aktgjykim refuzues për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.2 të KPK-së. Të akuzuarit i konfiskohen bimët narkotike: dhe atë 5 bimë të kanabisit, 50 farëra të kanabisit, 2 bimë të kanabisit, 1 bimë e kanabisit e marihuanës me peshë 376 gr., heroinë me peshë prej 1.26 gr., 250 farëra të kanabisit, armët: një revole e modelit 65 kalibri 4.5/177 dhe një fotrollë për armë, 24 fishekë të llojeve të ndryshme, 66 fishekë të kalibrit 7.65 dhe dy kutia, 3 fishekë të kalibrit 9 mm, 1 pistoletë Valther me numër serik 278130,23 fishekë të kalibrit 9 mm, 115 fishekë të kalibrave të gjuetisë të kalibrit të ndryshëm,38 fishekë mm dhe një shurdhues. Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate. Kërkesë pasurore juridike nuk ka pasur.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjorë ankesë ka paraqitur:

- Prokuroria Themelore në Mitrovicë, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën e Prokurorisë si të bazuar dhe ta anuloj tërësisht aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ashtu që lëndën ta kthej në rigjykim dhe rivendosje.

Prokurori i Apelit me parashtresën me shkrim PPA/I.nr.05/2018 të dt. 03.01.2018 ka propozuar që ankesa e Prokurorisë të aprovohet si e bazuar, aktgjykimi të anulohet dhe lënda ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje juridiko-penale studio aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

-ankesa nuk është e bazuar.

Prokuroria në ankesë pretendon se me aktgjykimin e goditur gjykata ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale për arsye se ka zbatuar gabimisht dispozitën e nenit 364 par.1 pika 1.3 të KPPK kur të akuzuarin e ka liruar nga aktakuza edhe pse nga provat që gjenden në shkresat e lëndës pa dyshim rrjedh se i akuzuari i ka kryer veprat penale me të cilat ngarkohet. Në arsyetimin e aktgjykimit theksohet se trupi gjykues pas vlerësimit të këtyre provave vërtetoi se në veprimet e të akuzuarit nuk sajohen elementet e veprave penale për të cilat akuzohet i akuzuari. Po ashtu theksohet prandaj në mungesë të provave e në vështrim të nenit 364 par.1 pika 1.3 trupi gjykues merr aktgjykim lirues, andaj kjo e bënë arsyetimin e aktgjykimit konfuz dhe kontradiktor. Nga provat materiale, procesverbali mbi bastisjen e shtëpisë dhe lokaleve përcjellëse të akuzuarit rezulton se bimët narkotike dhe substanca narkotike e heroinës dhe marihuanës janë gjetur dhe konfiskuar gjatë kontrollimit të shtëpisë të akuzuarit, i akuzuari ka qenë prezent dhe ka nënshkruar procesverbalin dhe kjo vërtetohet nga shikimi i këtij procesverbali. Po ashtu nga lista e gjërave të konfiskuara vërtetohet fakti se nga i akuzuari policia ka konfiskuar bimë të kanabisit, sasinë e heroinës dhe marihuanës dhe se i akuzuari e ka nënshkrua pa vërejtje do të thotë nuk e ka kontestuar se nuk janë të tijat. Me aktgjykimin e goditur gjykata e ka bërë edhe vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike se pse nga provat që gjenden në shkresat e lëndës pa dyshim rrjedh se i akuzuari i ka kryer veprat penale për të cilat ngarkohet sipas aktakuzës. Gjykata ia ka dhënë besimin mbrojtjes së të pandehurit mirëpo nuk ka vlerësuar dhe marrë për bazë provat materiale të lartcekura që në oborr dhe shtëpi të akuzuarit janë gjetur dhe konfiskuar bimët narkotike.

Gjykata e Apelit me vëmendje ka shqyrtuar aktgjykimin e shkallës së parë, ankesën e Prokurorisë si dhe shkresat e lëndës dhe vlerëson se aktgjykimi i atakuar me ankesë nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale. I njëjti ka të paraqitura arsyet për çdo pikë të aktgjykimit, është paraqitur qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i konsideron të vërtetuara apo të pa vërtetuara. Ka vlerësuar saktësinë e provave kundërthënëse si dhe arsyet e

mosmiratimit të propozimit konkret të palëve si dhe arsytet me të cilat është bazuar me rastin e zgjidhjes së kësaj çështjeje penalo-juridike e veçanërisht me rastin e vërtetimit të ekzistimit apo mos ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të akuzuarit në këtë çështje penale. Gjykata e shkallës së parë në aktgjykim ka dhënë arsytet për faktet vendimtare, ka arsyetuar secilën provë veç e veç duke i ndërlidhur me njëra tjetrën dhe duke e vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike. Gjykata e shkallës së parë ka administruar provat materiale dhe jo materiale dhe atë ka dëgjuar dëshmitarin B.S. i cili ka theksuar se është konsumues i marihuanës, se gjatë qëndrimit në Shqipëri i ka marrë disa fara të llojit kanabis dhe i ka mbjellur, i ka kultivuar dhe pas rritjes së tyre ja ka marrur farërat dhe i ka përdorur për vete. Se i akuzuari Xh. nuk ka qenë në dijeni se i ka mbjellur këto substanca narkotike. Nga provat materiale janë administruar raporti policor i dt. 09.08.2010, raporti nga vendi i ngjarjes i dt. 05.08.2010, procesverbali i bastisjes i po të njëjtës datë, lista e dëshmimeve nga dosja e hetimeve të forenzikës e dt. 05.08.2010, lista e dëshmimeve me nr. të dosjes 101 e po të njëjtës datë, lista e gjërave të konfiskuara, foto albumi, raporti i ekspertizës i dt. 23.09.2010 dhe ai i dt. 08.11.2010, e që nuk janë kontestuese se në shtëpinë e të akuzuarit Xh.S. janë mbjellur bimët si në dispozitiv të aktgjykimit me peshë prej 825.39 gram të llojit kanabis dhe heroinë në peshë prej 0.34 gram, se nuk është kontesues se dëshmitari B.S. e ka axhë të akuzuarin Xh. dhe e ka pasur qelsin e tij gjatë qëndrimit të Xh. në Zvicërr ku i njëjti jeton dhe në shtëpinë e tij vjen herë pas here. Dëshmia e dëshmitarit B.S. si dhe provat tjera janë në përputhje edhe me mbrojtjen e të akuzuarit të cilat kanë qenë të njëjta gjatë të gjitha fazave të procedurës e ku u vërtetua se bimët në shtëpinë e të akuzuarit i ka mbjellur B.S. i cili edhe është përkujdesur për to duke i tharë dhe përpunuar e që këto veprime ka qenë e pamundur ti kryej i akuzuari kur dihet se i njëjti nuk jeton në Kosovë por në Zvicërr. Prandaj Gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur në mungesë të provave të akuzuarin Xh.S. e ka liruar nga akuza.

Meqë aktgjykimi nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë nuk kemi as shkelje të Ligjit Penal e që do të kushtëzonte anulimin e aktgjykimit.

Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.589/2017, më 16.01.2018

Procesmbajtësi,
Përparim Zeka

Kryetari i kolegjit- gjyqtari
1. Mejreme Memaj_____

Anëtarët e kolegjit:

2. Driton Muharremi_____

3. Have Haliti _____